



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Kodi i lëndës: INF 461
Lënda: Kirurgji e avancuar

PROGRAMI I LËNDËS								
Kirurgji e avancuar								
Titullari i lëndës:		Petraq Mustaqe <i>PhD në Kirurgji</i> _____						
Ngarkesa:	ECTS	Orë mësimi në auditor					Studim individual	Totali
		Leksion	Seminar	Lab	Praktikë	Projekt klinik		
	12	60	15	0	75	0	150	300
Tipologjia e lëndës		Lëndë karakterizuese e programit						
Viti akademik /Semestri kur zhvillohet lënda		Viti I, Semestri I						
Lloji i lëndës		E detyruar						
Programi i studimit		Master Profesional në Infermieri Kirurgjikale						
Kodi i lëndës		INF 461						
Adresa elektronike e titullarit / pedagogut të lëndës		petraq.mustaqe@univlora.edu.al						

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Përshkrimi i lëndës	<p>Në këtë modul studiohen problemet kirurgjikale madhore që prekin popullatën adulte. Nëpërmjet integritetit të njohurive mbi patologjitë kirurgjikale të përgjithshme dhe sipas organeve dhe sistemeve të organizmit do të trajtohen standartet bashkëkohore mbi trajtimin kirurgjikal dhe parandalimin e këtyre sëmundjeve. Një vëmendje e veçantë do të kushtohet moshave të treta për sindromat më të shpeshta geriatrike. Roli i infermieres profesionale që kujdeset për pacientët adultë, do të fokusohet në kontekstin e individit, familjes dhe komunitetit.</p>
Objektivat e lëndës	<ul style="list-style-type: none">▪ Njohja me organizimin dhe detyrat e shërbimit kirurgjikal dhe mikrokirurgjik.▪ Vlerësimi dhe monitorimi i të operuarit në periudhën pre/post - operatore.▪ Njohja me patologjitë kirurgjikale tek adultët, si dhe me strategjitë e menaxhimit të tyre.
Rezultatet e pritshme	<p>Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none">☞ Të njohë teknikat kirurgjikale të standarteve bashkëkohore.☞ Të diagnostikojë patologjitë kryesore kirurgjikale.☞ Të kenë njohuri për strategjitë moderne të menaxhimit të pacientëve adultë me patologji kirurgjikale, përpara dhe pas ndërhyrjes.☞ Të aftësohen për një analizë kritike të kërkimit në fushën e patologjive kirurgjikale.☞ Të formojnë shprehje për të gjykuar në mënyrë të pavarur modelet ekzistuese dhe të sugjerojnë rekomandime për ndërhyrje në sistem.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

KONCEPTET THEMELORE

- Bazat fiziologjike të sëmundjeve kirurgjikale
- Përkujdesjet shëndetësore gjatë periudhës preoperative, intraoperative dhe post operative, periudha e rehabilitimit.
- Njohja etiologjike, diagnostikimi, dhe trajtimi i sëmundjeve kirurgjikale, kujdesi infermieror për pacientët.

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
I.	<p>Tema 1: Pavioni i kirurgjisë. Organizimi i punës në spital. Detyrat e personelit infermieror. Përkufizimi i semiotikës kirurgjikale, Zhvillimi i Kirurgjisë në Shqipëri. <i>Ky Leksion mbledh detyrat e personelit në repartin e kirurgjisë, konceptet gjegjësitë.</i></p> <p>Tema 2: Shenjat dhe simptomat kryesore në sëmundjet kirurgjikale (Dhimbja abdominale, temperaturë e lartë.) Në leksion paraqiten qartë <i>se cilat janë ndërhyrjet infermierore në shenjat klinike në sëmundjet kirurgjikale..</i></p> <p>Tema 3: Shenjat dhe simptomat kryesore në sëmundjet kirurgjikale (Simptomat ezofageale, nauzetë dhe të vjellat, konstipacioni dhe diarreja.) Në leksion paraqiten qartë <i>se cilat janë ndërhyrjet infermierore në shenjat klinike në sëmundjet kirurgjikale..</i></p> <p>Tema 4: Asepsia dhe antisepsia. Larja e duarve të kirurgut dhe instrumentat <i>Cfarë janë metodat desinfektuese, si kryhen, agjentët dhe rëndësia e higjenes së duarve dhe instrumentave.</i></p>	<p>⁽¹⁾fq 9-17</p> <p>⁽¹⁾fq 41-56</p> <p>⁽¹⁾fq 56-68</p> <p>⁽¹⁾fq 93-101</p>	<p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Seminar 1 orë Praktikë 5 orë</p>
II.	<p>Tema 5: Përgatitja e fushës operative, periudha përpara operacionit dhe përgatitja preoperative . <i>Hapat që duhet të ndjekë një skuadër mjekësore të përgatitur fushën operative. Dhe periudhën përpara operacionit.</i></p> <p>Tema 6: Periudha postoperative dhe kujdesi për pacientin e operuar. <i>Hapat që duhet të ndjekë një skuadër mjekësore në periudhën postoperative.</i></p> <p>Tema 7: Hemorragjia dhe homeostaza. <i>Hemorragjia nga kavitetet e jashtme të trupit me pasojë të rënda jetën, të cilat kanë nevojë ndërhyrje urgjente nga stafi mjekësor.</i></p> <p>Tema 8: Hemorragjitë digjестive, shoku hemorragjik dhe transfuzioni i gjakut. <i>Hemorragjitë në kavitetet e brëndshme, shokun hemorragjik dhe transfuzionin e gjaku, të cilat kanë nevojë urgjente diagnostikim dhe trajtim nga stafi.</i></p>	<p>⁽¹⁾fq 112-119</p> <p>⁽¹⁾fq 120-128</p> <p>⁽¹⁾fq 128-135</p> <p>⁽¹⁾fq 135-145</p>	<p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Seminar 1 orë Praktikë 5 orë</p>
III.	<p>Tema 9: Infeksioni kirurgjikal, infeksioni i lëkurës, absesi dhe flegmona, infeksionet kirurgjikale të gishtave. <i>Njohja me procedurat të kryera nga stafi, në infeksionin kirurgjikal, infeksionin e lëkurës, absesi dhe flegmona, infeksionet kirurgjikale të gishtave.</i></p>	<p>⁽¹⁾fq 228-247</p>	<p>Leksion</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p>Tema 10: Parimet e përgjithshme të terapisë së infeksioneve kirurgjikale. osteomieliti, sepsesi kirurgjikal. Njohja ë studentëve me parimet e përgjithshme të terapisë së infeksioneve kirurgjikale. Osteomieliti, sepsesi kirurgjikal.</p> <p>Tema 11: Tumoret e indeve të buta, lipoma, hemangioma, fibroma.. <i>Njohja me tumoret e indeve të buta, lipoma, hemangioma, fibroma.</i></p> <p>Tema 12:Neurinoma, sarkoma dhe kanceri i lëkurës. <i>Njohja me Neurinomat, sarkomat dhe kanceri i lëkurës.</i></p>	<p>⁽¹⁾fq 256-266</p> <p>⁽¹⁾fq 267-277</p> <p>⁽¹⁾fq 278-287</p>	<p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Seminar 1 orë Praktikë 5 orë</p>
IV.	<p>Tema 13:Karakteristikat e përgjithshme të ulcerave, ulcerat venoze, ulcerat iskemike. <i>Hapat në ndjekjen e ulcerave duke iu referuar llojit të tyre.</i></p> <p>Tema 14: Ulcerat iskemike, neuropatike dhe ulcerat e rralla. <i>Njohja dhe hapat që duhen ndjekur në ulcerat iskemike, neuropatike dhe ulcerat e rralla.</i></p> <p>Tema 15:Karakteristikat e përgjithshme në Sinusi dhe Fistula <i>Njohja me sinuset dhe fistulat.</i></p> <p>Tema 16:Semiotika kirurgjikale e gjendrave salivare. <i>Njohja e studentit me semiotikën kirurgjikale të gjendrave salivare</i></p>	<p>⁽¹⁾fq 288-291</p> <p>⁽¹⁾fq 291-297</p> <p>⁽¹⁾fq 298-300</p> <p>⁽¹⁾fq 307-309</p>	<p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Seminar 1 orë Praktikë 5 orë</p>
V.	<p>Tema 17: Semiotika kirurgjikale e gjendrës tiroide <i>Njohja e studentit me semiotikën kirurgjikale të gjendrave tiroide</i></p> <p>Tema 18: Semiotika kirurgjikale e gjendrës paratiroide <i>Njohja e studentit me semiotikën kirurgjikale të gjendrave paratiroide</i></p> <p>Tema 19:Sëmundjet kirurgjikale të ezofagut <i>Njohja e studentit me sëmundjen e refluksit dhe ezofagitet nga refluksi, gjithashtu edhe njohja me divertikujt e ezofagut.</i></p> <p>Tema 20: Sëmundjet kirurgjikale të ezofagut <i>Njohja e studentit me dëmtimet e ezofagut, djegie, trupat e huaj, tumoret e ezofagut.</i></p>	<p>⁽¹⁾fq 310-315</p> <p>⁽¹⁾fq 316-317</p> <p>⁽²⁾fq 31-44</p> <p>⁽²⁾fq 45-52</p>	<p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Seminar 1 orë Praktikë 5 orë</p>
VI.	<p>Tema 21:Sëmundjet kirurgjikale të stomakut dhe duodenit, inflamacioni dhe dëmtimet e stomakut, djegiet e stomakut, trupat e huaj në stomak. <i>Njohja me sëmundjet kirurgjikale të stomakut dhe duodenit, inflamacioni dhe</i></p>	<p>⁽²⁾fq 57-65</p>	<p>Leksion</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p>dëmtimet e stomakut, djegiet e stomakut, trupat e huaj në stomak si edhe kujdesi infermieror në secilin prej rasteve të mësipërme.</p> <p>Tema 22: Sëmundjet kirurgjikale të stomakut dhe duodenit. Njohja me gastritet, sëmundja ulceroze gastro-duodenale, hemoragjitë gastroduodenale, perforacioni, stenoza, tumoret stomakut dhe duodenit.</p> <p>Tema 23: Sëmundjet kirurgjikale të zorrës së hollë. Njohja me tumoret e zorrës së hollë, shenjat klinike, diagnostikimi dhe trajtimi.</p> <p>Tema 24: Sëmundjet kirurgjikale të zorrës së hollë Njohja me divertikujt duodenalë dhe intestinalë, Morbus Chron, polipoza intestinale, polipoza juvenile, shenjat klinike, diagnostikimi dhe trajtimi.</p>	<p>(2)fq 66-90</p> <p>(2)fq 97-107</p> <p>(2)fq108-116</p>	<p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Seminar 1 orë Praktikë 5 orë</p>
VII.	<p>Tema 25: Sëmundjet kirurgjikale të kolonit. Njohja me divertikulozat, CA e kolonit, Ca e rektumit, shenjat klinike, diagnostikimi dhe trajtimi i tyre.</p> <p>Tema 26: Sëmundjet e apendisitit akut. Klinika dhe trajtimi Apendiksi është një inflamacion i zorrës qorre dhe mund të jetë akut ose kronik që prek të gjitha moshat, me etiologji të bakteriale, trajtimi është kirurgjikal tek ai akut. Është shkaku më i shpeshtë i sindromit akut doloroz</p> <p>Tema 27: Ileusi intestinal akut. Diagnoza dhe trajtimi Blokimi mekanik ose paralitik i zorrës dhe është situatë emergjente për pacientin që kërkon ndërhyrje kirurgjikale dhe kujdes të vecantë sidomos tek moshat e reja.</p> <p>Tema 28: Peritonitet, llojet, trajtimi Inflamacion i peritoniumit në kavitetin peritoneal, acute, kronike, septike, primare dhe sekondare dhe te lokalizuara dhe difuze. Fillojnë me nga shkaqe të ndryshme që manifestohet me dhimbje të forta, temperaturë dhe gjendje e përgjithshme e rënduar, gjë që kërkon kujdes imediat</p>	<p>(2)fq 123-141</p> <p>(2)fq 147-153</p> <p>(2)fq 157-169</p> <p>(2)fq 175-185</p>	<p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Seminar 1 orë Praktikë 5 orë</p>
VIII.	<p>Tema 29: Tumoret e heparit. Diagnoza dhe trajtimi, Tumoret malinje të heparit marrin origjinë nga indet përbërëse, kanë shumë metastaza dhe janë me prognozë kryesisht jo të kënaqshme sepse metastazon në rrugë hematogjene dhe limfatogjene.</p> <p>Tema 30: Sëmundjet inflamatore dhe parazitare të heparit Njohja me Sëmundjet inflamatore dhe parazitare të heparit, dhenjat klinike, diagnostikimin dhe trajtimin e tyre.</p> <p>Tema 31: Sëmundjet e rrugëve biliare dhe ekstrahepatike</p>	<p>(2)fq 190-200</p> <p>(2)fq 201-213</p>	<p>Leksion</p> <p>Leksion</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>Kalkuloza biliare është më e përhapura, me etiologji si trashëgimia, rraca, gjinia, hormonet etj, dhe trajtimi është kryesisht medikamentoz, dietetik dhe kirurgjikal. Është përgjegjëse e kolikave abdominale në 70% të rasteve.</i></p> <p>Tema 32: Kolecistiti akut. Diagnoza dhe trajtimi, <i>Inflamacion i kolecistës me etiologji bakteriale, mekanike me komplikacione të shumta dhe trajtimi kryesisht kirurgjikal.</i></p>	<p>⁽²⁾fq 217-221</p> <p>⁽²⁾fq 222-235</p>	<p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p><i>Seminar 1 orë Praktikë 5 orë</i></p>
IX.	<p>Tema 33: Pankreatiti akut. Diagnoza dhe trajtimi <i>Është process inflamator akut I shkaktuar nga aktivizimi dhe autodigjestion i gjendrës nga enzimat e prodhuara prej tij, prek moshat 30-50 dhe të dy gjinitë.</i></p> <p>Tema 34: Pankreatiti kronik . Diagnoza dhe trajtimi. <i>Është inflamacion kronik I pankreasit irrversibël që con në sklerozë progressive të parenkimës së gjendrës dhe insuficencë pankreatike endocrine dh egzokrine.</i></p> <p>Tema 35: Tumoret e pankreasit <i>Njohja me llojet e ndryshme të tumoreve të pankreasit, shenjat klinike diagnostikimin dhe mënyrën e trajtimit.</i></p> <p>Tema 36: Hipertensioni portal <i>Hipertensioni portal është një patologji që karakterizohet nga rrihta mbi normë e e presionit në venën porta dhe degët e saj.</i></p>	<p>⁽²⁾fq 249-257</p> <p>⁽²⁾fq 258-261</p> <p>⁽²⁾fq 261-272</p> <p>⁽²⁾fq 277-280</p>	<p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p><i>Seminar 1 orë Praktikë 5 orë</i></p>
X.	<p>Tema 37: Sëmundjet kirurgjikale të shpretkës. Diagnoza dhe trajtimi, <i>Kistet, tumoret dhe traumat janë më të shpeshtat dhe të gjitha kërkojnë ndërhyrje kirurgjikale dhe kujdes imediat</i></p> <p>Tema 38: Sëmundja Herniare <i>Njohja me herniet inguinale, femorale, komplikacionet, shenjat klinike, diagnostikimi dhe trajtimi.</i></p> <p>Tema 39: Trauma Abdominale <i>Trauma konsiderohet si një dëmtim i organizmit i shkaktuar si pasojë e veprimit të një force të jashtme, energjia e së cilës është më e madhe se aftësia pritëse e organizmit.</i></p> <p>Tema 40: Sëmundjet kirurgjikale të rektumit dhe anusit. Hemorroidet. Trajtimi konservativ dhe kirurgjikal <i>Janë protuberanca venozë në rektum të brëndhsme ose të jashtme me tendenca hemoragjike dhe që janë kryesisht të trajtueshme në fazat e para me medikamente dhe ma pas me ndërhyrje kirurgjikale duke bëtë heqjen e tyre.</i></p>	<p>⁽²⁾fq 285-292</p> <p>⁽²⁾fq 297-317</p> <p>⁽²⁾fq 371-378</p> <p>⁽²⁾ fq 459-464</p>	<p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p><i>Seminar 1 orë Praktikë 5 orë</i></p>



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
XI.	<p>Tema 41: Fistulat anale dhe fissura anale. Trajtimi <i>Carje dhe dëmtime të paretit anal dhe rektal longitudinal duke u manifestuar me hemoragji dhe shqetësime të vazhdueshme të pacientit. Kërkojnë ndërhyrje korrektuese.</i></p> <p>Tema 42:Principet e terapisë adjuvante në mjekimin e tumoreve <i>N ë ditët e sotme sëmundjet tumorale po gjejnë një përhapje të gjerë, dhe terapia adjuvante është mjaft e rëndësishme.</i></p> <p>Tema 43:Sëmundjet e gjendrës tiroide, Hipertiroidizmi, Struma. <i>Njohja e studentit me sëmundjet e mbifunksioni t të gjendrës tiroide, manifestimet klinike, diagnostikimi dhe trajtimi.</i></p> <p>Tema 44: Tiroiditet dhe tumoret e tiroides. <i>Njohja e studentit me tiroiditet dhe tumoret e gjendrës tiroide, manifestimet klinike, diagnostikimi dhe trajtimi.</i></p>	<p>⁽²⁾ fq468-475</p> <p>⁽²⁾ fq485-491</p> <p>⁽²⁾ fq 326-334</p> <p>⁽²⁾ fq 334-344</p>	<p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Seminar 1 orë Praktikë 5 orë</p>
XII.	<p>Tema 45: Sëmundjet kirurgjikale të gjendrave paratiroide <i>Njohja me sëmundjet kirurgjikale që prekin gjendrën paratiroide.</i></p> <p>Tema 46: Sëmundjet kirurgjikale të gjendrave paratiroide. <i>Hiperparatiroidizmi primar dhe hipoparatiroidizmi, shenjat klinike, diagnostikimi dhe trajtimi.</i></p> <p>Tema 47: Sëmundjet e gjendrave suprarenale <i>Njohja e studentit me sindromën Cushing, Feocromocitoma, karcinoma e suprarenales, shenjat klinike, diagnostikimi dhe trajtimi i tyre.</i></p> <p>Tema 48: Sëmundjet dhe tumoret beninje të gjirit. <i>Njohja e patologjive të gjirit, atyre me natyrë beninje, dhe trajtimi në cdo situatë.</i></p>	<p>⁽²⁾ fq 349-352</p> <p>⁽²⁾ fq 352-357</p> <p>⁽²⁾ fq362-368</p> <p>⁽²⁾ fq362-388</p>	<p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Seminar 1 orë Praktikë 5 orë</p>
XIII.	<p>Tema 49: Kanceri i gjirit <i>Njohja e studentit me kancerin e gjirit, shenjat klinike, diagnostikimin , trajtimin dhe parandalimin si një nga patologjitë që shkakton numrin më të madh të vdekjeve te femrat.</i></p> <p>Tema 50:Sëmundjet e mushkërive, semiologjia e sëmundjeve të mushkërive. <i>Njohja e studentit me simptomat që hasen më shpesh në këto patologji dhe metodat ekzaminuese.</i></p> <p>Tema 51: Anomalitë e lindura të mushkërive <i>Anomalitë e lindura të mushkërive mund të shfaqen klinikisht që në lindje me detres respirator të rëndë dhe në këtë rast është e nevojshme ndërhyrja urgjente te këta pacientë.</i></p>	<p>⁽²⁾ fq 389-403</p> <p>⁽²⁾ fq409-414</p> <p>⁽²⁾ fq415-418</p>	<p>Leksion</p> <p>Leksion</p> <p>Leksion</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	Tema 52: Emfizema, Abcesi i mushkërisë, Bronkoektazia <i>Njohja e studentit me shenjat klinike, diagnostikimin trahtimin dhe menaxhimin e patologjive, Emfizema, Abcesi i mushkërisë dhe Bronkoektazia.</i>	(2) fq418-424	Leksion <i>Seminar 1 orë Praktikë 5 orë</i>
XIV.	Tema 53: Tumoret pulmonare <i>Njohja me tumoret pulmonare, diagnostikimin, klinikën, ecurinë dhe trajtimin e tyre.</i> Tema 54: Sëmundjet e pleurës, Hemotoraksi dhe Pneumotoraksi <i>Njohja me Sëmundjet e pleurës Hemotoraksin dhe Pneumotoraksin, diagnostikimin, klinikën, ecurinë dhe trajtimin e tyre.</i> Tema 55: Endoskopia digjестive <i>Endoskopia sot përbën një metodë të rëndësishme dignostiko-kuruese.</i> Tema 56: Kirurgjia mini invazive, laparoskopike <i>Njohja e studentëve me metodat e reja të kirurgjisë mini invazive.</i>	(2) fq426-439 (2) fq440-450 (2) fq 495-504 (2) fq 507-512	Leksion Leksion Leksion Leksion <i>Seminar 1 orë Praktikë 5 orë</i>
XV.	Tema 57: Parime të përgjithshme të terapisë transplatuese <i>Transplanti i organeve është bërë një trajtim i përzgjedhur për sëmundjet e staveve të fundit.</i> Tema 58: Venat varikoze <i>Ky term nënkupton zgjerimin segmentar të një vene të shoqëruar me ndryshime të parikthyeshme të strukturës dhe funksionit të saj.</i> Tema 59: Sindroma e pengesës së shkarkimit venoz <i>Janë sindroma të karakterizuara nga kompleksi i ndryshimeve anatomo-fizio-patologjike të përcaktuara nga një pengesë e defluksit venoz dhe kuadri klinik është i ndryshëm në varësi të lokalizimit.</i> Tema 60: Sindroma pastrombotike <i>Sindroma pastrombotike është një gjendje si pasojë e trombozës akute të venave të thella dhe që shkakton një invaliditet të lartë.</i>	(2) fq 513-522 (1) 474-476 (1) 477-481 (1) 482-483	Leksion Leksion Leksion Leksion <i>Seminar 1 orë Praktikë 5 orë</i>

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

FREKUENTIMI:	Kyçi i një edukimi të suksesshëm është pjesëmarrja dhe përgatitja. Kërkohej një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e praktikës janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të zëvendësohet në marrveshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e praktikës në orarin e përcaktuar dhe të pajisur me përparëse të bardhë dhe flokë të mbledhur (duke respektuar kodin etik të veshjes së infermierit). Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të kundërt studentit humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura.					
KONTROLLI I	<i>Forma e</i>	<i>Koha e</i>	<i>Temat mësimore</i>	<i>Pikët</i>	<i>Forma e testimit të</i>	<i>Përmbajtja e</i>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

VAZHDIESHËM	<i>vlerësimi</i>	<i>vlerësimi</i>	<i>që do vlerësohen</i>	<i>maksimale</i>	<i>njohurive</i>	<i>testimit</i>
	Provimi final	Fundi i semestrit	Tema 1-60	90 pikë	Provimi me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Vlerësim i vazhduar* (Detyra e kursit*)	Java 14/15	Rastet klinike	10 pikë	Prezantim me gojë	Raportim rasti / Demonstrim procedure
<i>*Detyra e kursit</i> - Do të jetë në formën e një projekti që do të nisë në fillim të semestrit. Studentët do të përshkruajnë rastet më të shpeshta të patologjive pediatrike apo neonatale, që hasin në praktikë, duke i krahasuar me përshkrimet teorike të patologjive. Gjithashtu do të realizojnë dhe 3 plane kujdesi, bazuar në një format të gatshëm, për asistencën shëndetsore të hasur në praktikë. Një pjesë e punimeve do të prezantohen dhe në PPT.						
Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare do të jetë si më poshtë:						
	40- 49 pikë	50-59 pikë	60-69 pikë	70-79 pikë	80-89 pikë	90-100 pikë
	5	6	7	8	9	10

LITERATURA

Literatura bazë e detyruar	1. "Semiotika Kirurgjikale" Prof.asc. Etmont Celiku et al, 2011 (Fakulteti i Mjekësisë - UT) 2. "Sëmundjet Kirurgjikale" N.Kacani, 2006 Fakulteti i Mjekësisë - UT
Literatura e rekomanduar	1. Medical-Surgical Nursing, 10th Edition, (2017) Sharon Lewis et al, ISBN-13: 978-0323328524. 2. Med-Surg Success: A Q&A Review Applying Critical Thinking to Test Taking (Davis's Q&A Success) 3rd Edition (2017) Kathryn Cadenhead Colgrove RN MS CNS , ISBN-13: 978-0803644021

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS

Dispozita:	Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregon interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto pritshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjatë procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuara.
Vonesat	Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student.
Sjellja profesionale e studentit	Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

	<p>nëpër tavolinat e mësimit, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimit, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijancë nga këto rregulla, do të ketë penalitete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.</p>
Integriteti akademik dhe e drejta e autorit	<p>Çdo test apo punë me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale. Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale, dhe në pamundësi të referojnë gjithnjë burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzierjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme.</p>
Karakteristikat e detyrave të kursit	<p style="text-align: center;">RAPORTIMI I RASTIT</p> <p><i>Gjeneralitetet</i> – emri, mbiemri, moshë, venbanimi <i>Epidemiologjia</i> (përhapja) e sëmundjes – ku haset me shpesh: në ç’vend dhe në ç’periudhë të vitit. <i>Etiologjia</i> (shkaktarët) e sëmundjes – cili ka qenë shkaku i sëmundjes së pacientit që po raportohet. Veç kësaj do të përmenden edhe shkaktarët e tjerë të kësaj sëmundjeje sipas literaturës. <i>Klinika</i> e sëmundjes:</p> <ul style="list-style-type: none">○ Gjithë paraqitja klinike e sëmundjes në momentin e raportimit○ Ecuria klinike që nga momenti i fillimit të sëmundjes (anamnezis morbi) Gjatë paraqitjes klinike të sëmundjes do të evidentohen tiparet klinike karakteristike të sëmundjes që paraqet pacienti, së bashku me shenja të tjera klinike që nuk janë tipike apo nuk janë pjesë e kësaj sëmundjeje.○ Paraqiten gjithë problemet e tjera shëndetsore apo të stilit të jetesës që ka pacienti, si dhe mënyrat e mundshme sesi ato mund të kenë ndikuar në klinikën apo trajtimin e sëmundjes bazë (anamnezis vitae)○ Pas kësaj, duke iu referuar literaturës, do të paraqitet spektri i plotë i tipareve klinike dhe komplikacioneve të sëmundjes në fjalë. <p><i>Diagnostikimi:</i></p> <ul style="list-style-type: none">▪ Do të paraqitet diagnoza klinike e vendosur nga mjeku përkatës dhe do të argumentohen arsyet pse është vendosur kjo diagnozë.▪ Do të renditen ekzaminimet që ka kryer pacienti dhe do të referohen nga literatura të gjitha ekzaminimet e mundshme, duke nënvizuar ekzaminimin kyç në vendosjen e diagnozës së kësaj sëmundjeje. <p><i>Trajtimi:</i></p> <ul style="list-style-type: none">▪ Do të paraqitet ecuria e trajtimit që nga fillimi i sëmundjes, çfarë është ndryshuar në këtë plan trajtimi apo plan asistence dhe pse.▪ Do të paraqitet trajtimi aktual i të sëmurit, duke argumentuar arsyet pse është vendosur në këtë plan asistence në momentin aktual të zhvillimit të sëmundjes.▪ Do të referohen nga literatura planet e tjera të mundshme të asistencës së të sëmurit. Do të krahasohen ato me planin aktual të asistencës të pacientit.▪ Do të jepen rekomandimet e mundshme për përmirësimin e planit aktual të asistencës së pacientit. <p><i>Prognoza</i> (parashikimi mbi ecurinë e sëmundjes):</p> <ul style="list-style-type: none">○ Do të referohet prognoza e pacientit sipas mjekut që e ndjek.○ Do të bëhet një parashikim sipas mendimit personal të referuesit. <p>Rregullat për paraqitjen e detyrave / projekteve të kursit:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ Të gjitha punimet duhet të dorëzohen në kohën e caktuar. Ato duhet të tregojnë që në paraqitje një stil profesionist.▪ Duhet të jenë të shtypura. Punet me shkrim dore nuk do të pranohen dhe studenti do të vlerësohet automatikisht me 0 pikë.▪ Në punime gjuha duhet të jetë zyrtare, letrare dhe neutrale. Ndalohen rreptësisht përdorimet e zhargoneve të pa argumentuara, shprehjet që rëndojnë etikën



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

	<p>profesionale dhe njerëzore, kërcënimet, fyerjet, sharjet, etiketimet, tendencat politizuese, trajtimet jashtë tematikave të kërkuara, etj.</p> <ul style="list-style-type: none">▪ Punët duhet të kenë një volum me më tepër se 3 faqe (format A⁴, shkrimi Times New Roman, 12 pt) dhe në faqet e para duhet të jenë të shënuara pa gabime drejtshkrimore: <div data-bbox="646 527 1352 730" style="border: 1px solid black; padding: 5px;"><p>Emri i Studentit Titulli i punimit Kursi dhe grupi përkatës i studentit Data e dorëzimit të punimit sipas grafikut të shpallur Emri i instruktorit Numri i faqeve</p></div> <p><i>Elementët e vlerësimit të detyrës së kursit do të përfshijnë:</i> Thelbësore:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ Respektimin e strukture së punimit shkencor▪ Renditjen e argumenteve akademiko-shkencorë▪ Mënyrat specifike të trajtimit të çështjeve në raport me realitetin shqiptar <p>Ndihmëse:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ Ideja e zgjedhur▪ Mënyra e organizimit të punimit▪ Logjika e përdorimit të koncepteve▪ Përputhja me objektivat e programit mësimor▪ Argumentet dhe analiza kritike
--	--